Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

AVSI
People for development


WIDSH
Women in Development

SHIS
SHOQATA INTERNACIONALE
PËR SOLIDARITETIN

TFL
TOGETHER FOR LIFE

Skenari: Alma Lahe Ilustrimet: Kosta Raka

Më dëgjoni, mos më ndëshkoni!



Ky tregim i ilustruar (fumet) është realizuar nga "Together for Life" në kuadër të projektit "Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi nëpërmjet edukimit gjithëpërfshirës", i cili zbatohet në kuadër të skemës së granteve të vogla të projektit "Promovimi i të drejtave të njeriut nëpërmjet arsimit gjithëpërfshirës dhe fuqizimit të Organizatave të Shoqërisë Civile Lokale" i financuar nga BE dhe i zbatuar nga "Shoqata Internacionale për Solidaritetin në partneritet me Fondacionin AVSI dhe shoqatën Gruaja në Zhvillim Shkodër.

Nëpërmjet një ngjarjeje të ilustruar jepen mesazhe dhe këshilla për fëmijët, prindërit dhe mësuesit, që ata të kuptojnë se të gjitha format e dhunës që ushtrohen ndaj fëmijëve janë të dëmshme dhe me pasojë fizike dhe psiko-emocionale për ta. Është detyrë e prindërve dhe mësuesve që të marrin masa për t'i mbrojtur fëmijët nga çdo formë dhune dhe nga çdo ushtrues dhune, pavarësisht statusit të tij në lidhje më fëmijën.

Prindërit dhe mësuesit duhet të kuptojnë se disiplinimi dhe edukimi i fëmijëve duhet bërë me mjete pozitive dhe jo duke përdorur dhunën dhe shtrëngimin.
Për të përcjellë mesazhe të forta kundër dhunës ndaj fëmijëve në shkollë dhe familje, është zgjedhur fumeti si mjet komunikimi tërheqës për të gjithë dhe shumë i thjeshtë për t'u kuptuar nga të gjithë, pavarësisht moshës, edukimit dhe gjendjes shoqërore.
Qëllimi i tij është të ndihmojë prindërit të përmirësojnë aftësitë e komunikimit dhe sigurinë e fëmijëve.

Mbrojtja e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës është detyrim i çdo shteti palë në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për të Drejtat e Fëmijës", ku përcaktohet se "fëmijës i njihet e drejta të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën ose zhvillimin e tij normal".


Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Together for Life dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e BE.


TOGETHER FOR LIFE

Rr. Brigada VIII, Pallati Jeshil Tekno-Projekt, Shk.2, Ap.14

Email: info@togetherforlife.org.al

Web: www.togetherforlife.org.al



Jetar, Ormir, mos bëni rrëmujë.
Po rregulloj shtëpinë.
1
Prandej je vajzë. Të bësh punë
ndërsa ne jemi djem dhe do luajmë.
Bëji prapë. Atë punë ke ti.
2



Pauuuu!
3
Bobooo! Çfarë bëtë?
Mami do të nxehet.
Le pastaj, babi...
Ty do të dënojnë.
Ti je e madhja.
4



Gjithmonë unë e kam fajin!
5



6


Arsa, pse i lë vëllezërit të luajnë me tablet? Sa herë të kam thënë?
7
Po nuk më dëgjojnë, mami. Kur ua mora tabletin, më grisën fletoren e gjuhës.
Janë të vegjël. Përgjigjesh ti për ta. Dhe, pusho, mos më kthe fjalë!
8


Uauuuu! Ku është abazhuri?
Kush e theu, Arsa?
9
U thashë të mos luanin me top, mami,
por nuk më dëgjuan.
Qepe! Të thashë,
nuk dua të ta
dëgjoj zërin.
10


Bobo, më piu e zeza.
Erioni do të më bëjë namin!
11
12
Babi! Babi!
Çunat e babit,
azganët e babit!
13


Çfarë ke bërë për drekë, moj grua?
Gjellë me spinaq dhe sallatë.
14
Pse lopë jam unë të ha barishte?
Jam burri i shtëpisë. Nëse e ke harruar, ta kujtoj unë!
Të kam skuqur edhe një copë mishi.
15


Ti, moj, lëri ato libra dhe shko poshtë në market e më bli dy birra.
16
Mos t'ua dëgjoj zërin asnjërës. Ma shkatërruat shtëpinë ju të dyja dhe ua hidhni fajin djemve. Ata janë të vegjël. Ç'bëni ju kur ata luajnë? Rrini e shihni televizor?
Babi, mami nuk ka faj. Vetëm unë isha në shtëpi dhe u thashë...
17


Thashë, mos t'jua dëgjoj zërin!
Pauu!
18
Asgjë. Isha mbështetur mbi pëllëmbë.
Ua, ç'të ka faqja kështu?
19

I the që nuk ishte faji yt? Që mësuesja nuk të pyeti për mësimin, por të akuzoi pa të drejtë se po bëje zhurmë? Dhe zhurmën e bënë të tjerët?

Arsa, i tregove mamit për katrën që more në matematikë?




20

Nuk i them gjë askujt. Kush më dëgjon mua? As mësuesja nuk më dëgjoi. më tha “Mbylle gojën! E di unë!”. Askush nuk më dëgjon dhe beson. Unë jam një hiç.



21

Vogëlushja ime, sa e pambrojtur ndjehet. Si unë dikur, në moshën e saj. Është i gjithi faji im. Si u bëra si prindërit e mi dikur? MJAFT! Kjo duhet të marrë fund tani, këtu. Do ta mbroj vajzën time nga i ati, nga vetja ime dhe nga të gjithë ata që e lëndojnë. Vajza nuk do të ketë jetën time!



Mami të beson dhe është gati të të dëgjojë gjithmonë! Ti je gjithçka për ne. Sot do të flas me babanë dhe nesër do të vij në shkollë të takoj dhe të flas me mësuesen!



Ilustrimet nga Kosta Raka

TË DASHUR FËMIJË, DENONCONI DHUNËN

Askush nuk mund të cenojë zhvillimin tuaj fizik apo emocional! Evidentoni dhe denonconi çdo lloj dhune dhe abuzimi ndaj jush! Kujdes! Jo çdo i rritur apo bashkëmoshatar është i besueshëm! Mos iu bindni askujt që ju krijon ndjenja pasigurie, ju lëndon apo ju ngjall frikë!



Prindër

Fëmijët kanë nevojë të dinë që ju i dëgjoni, i besoni dhe i mbroni! Jepuni fëmijëve tuaj një strehë të sigurt dhe të paqtë! Mbrojini fëmijët nga njerëzit e dhunshëm!

Mësues

Njihni dhe përmbushni nevojat e fëmijëve të ekspozuar ndaj dhunës dhe referojini ata në shërbimet e duhura. Krijoni marrëdhënie të besueshme me fëmijët, ndihmojini të zvogëlojnë stresin e të jetuarit në mjedise të dhunshme; Adresoni nevojat e fëmijëve nëpërmjet programeve të posaçme për të siguruar mbështetje dhe mbrojtje të përshtatshme.

Together for Life (Adresa: Rr. Brigada VIII, Pallati Jeshil Tekno-Projekt, Shk.2, Ap.14. Email: info@togetherforlife.org.al)